

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz nr. 61/2012

2 tetor 2012

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit Horst Proetel si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues dhe gjyqtarët Valdete Daka, Marije Ademi, Marti Harsia dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, në praninë e Zyrtares Ligjore Chiara Rojek, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses,

Në procedurën penale kundër:

**S.A.**, emri i babait , emri i nënës , i lindur më , në komuna e , vendbanimi i fundit , me shtetësi të Kosovës,

**F.P.**, emri i babait , emri i nënës , i lindur më në , vendbanimi i fundit , me shtetësi të Kosovës,

**I.K.**, me nofkën , emri i babait , emri i nënës , i lindur më në , vendbanimi i fundit , me shtetësi të Kosovës,

**X.H.**, emri i babait , emri i nënës , i lindur më , vendbanimi i fundit , me shtetësi të Kosovës,

**S.S.**, emri i babait , emri i nënës , i lindur më , vendbanimi i fundit në lagjen , me shtetësi të Kosovës,

**A.H.**, emri i babait , i lindur më , komuna , vendbanimi i fundit fshati , me shtetësi të Kosovës,

**B.A.**, emri i babait , emri i nënës , i lindur më , vendbanimi i fundit në lagjen , me shtetësi të Kosovës,

Të dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 244/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2011 me të cilin **A.H.** dhe **S.A.** janë shpallur fajtor për veprën penale të Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe për Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, dhe janë dënuar me dënim unik prej shtatëmbëdhjetë (17) vjet burgim dhe një gjobë prej 200.000 euro (**S.A.**), dhe me dënim unik prej nëntëmbëdhjetë (19) vjet burgim dhe një gjobë prej 250.000 euro (**A.H.**); **F.P.** dhe **X.H.** janë shpallur fajtor për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, dhe janë dënuar me dënim unik prej shtatë (7) vjet burgim (**F.P.**) dhe dënim me kusht prej dy (2) vjet burgim (**X.H.**), dhe janë liruar nga vepra penale e Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të KPK, **I.K.** dhe **S.S.** janë shpallur fajtor për veprën penale të Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të KPK dhe secili është dënuar me nga tetë (8) vjet burgim, dhe janë liruar nga vepra penale e Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, dhe **B.A.** është shpallur fajtor për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, dhe është dënuar me dënim unik prej pesë (5) vjet burgim, ndërsa është liruar nga vepra penale e Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të KPK,

Duke vepruar sipas ankesave të ushtruara nga i pandehuri S.A., avokati i tij mbrojtës Florin Vertopi, nga avokati mbrojtës Shemsedin Piraj në emër të të pandehurit F.P., nga avokati mbrojtës Qerim Zogaj në emër të të pandehurit I.K., nga avokati mbrojtës Hilmi Zhitija në emër të të pandehurit X.H., nga avokati mbrojtës Ndue Thaqi në emër të të pandehurit S.S.,

nga avokati mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit A.H. dhe nga avokati mbrojtës Gëzim Kollçaku në emër të të pandehurit B.A., të gjitha kundër aktgjykimit P nr. 244/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2011, dhe duke pasur në konsideratë Mendimin dhe propozimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) të paraqitur më 5 prill 2012,

Pas mbajtjes së seancës së hapur më 2 tetor 2012 në praninë e të pandehurit Shpejtim Ademaj dhe avokatit të tij mbrojtës Florin Vertopi, të pandehurit F.P. dhe avokatit të tij mbrojtës Shemsedin Piraj, të pandehurit I.K. dhe avokatit të tij mbrojtës Qerim Zogaj, të pandehurit X.H. dhe avokatit të tij mbrojtës Hilmi Zhitija, të pandehurit S.S. dhe avokatit të tij mbrojtës Ndue Thaqi, të pandehurit t A.H. dhe avokatit të tij mbrojtës Bajram Tmava, të pandehurit B.A. dhe avokatit të tij mbrojtës Gëzim Kollçaku, dhe pas këshillimit dhe votimit më 2 tetor 2012,

Në pajtueshmëri me Nenet 420 dhe më pas të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë

### **AKTGJYKIM**

1. Të gjitha ankesat e ushtruara nga mbrojtja kundër aktgjykimit P nr. 244/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2011 **REFUZOHEN**. Të pandehurit mbeten me dënim të njëjtë sikurse është shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Aktgjykimi i shkallës së parë **MODIFIKOHET** *ex officio* lidhur me emërtimin ligjor të veprave penale me sa vijon:

“**A.H.** dhe **S.A.** janë

### **SHPALLUR FAJTOR**

*për veprën penale të Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të KPK lidhur me veprën Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me Nenin 23 të KPK-së, sepse gjatë vitit 2009, deri në tetor 2009, në territorin e Kosovës, në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në veprimtaritë penale të një grupi të organizuar të përbërë prej vet tyre, A.G., I.R., një person me nofkën J., I.K., S.S. dhe njerëz të tjerë që ende nuk janë identifikuar. Veprimtaria kryesore e grupit të organizuar ishte kontrabandimi i kundërligjshëm i migrantëve nga Kosova në vendet e tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) duke fituar në këtë mënyrë përfitime të larta materiale nga aktiviteti i lartë përmendur. Organizata ka mundur të llogaris në një strukturë të organizuar mirë e cila nën udhëheqjen e A. G., në shkëmbim të një shumë të hollash e cila ndryshon nga 3000 në 1500 euro për një migrant, ka marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova në Serbi (për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishin të përfshirë A.H., I. R., S.A., I.K. dhe S.S.) pastaj përmes Serbisë ( për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishte përgjegjës J.) dhe pastaj nga Serbia në Hungari (për këtë pjesë të veprimtarisë penale përgjegjës ishte A.G.) dhe prej atje në caqet e përmendura më lart. Veprimtaritë e grupit të organizuar kanë rezultuar, më 14 tetor 2009, në vdekjen e këtyre migrantëve:*

*E.J., I.A., B.K., F.A., E.A, A.A., F.A., L.K., A.K., A.K. 2, R.M., V.M., D.M., D.M. 2 and A.M..*

**I.K.** dhe **S.S.** janë

## **SHPALLUR FAJTOR**

*për veprën penale të Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 2 të KPK lidhur me veprën Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, pra është ri-klasifikuar akuza origjinale, sepse nga qershor deri në shtator 2009, në territorin e Kosovës, në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në veprimtaritë penale të një grupi të organizuar të përbërë prej vet tyre, A.G., I.R., një person me nofkën J., A.H., S.A. dhe njerëz të tjerë që ende nuk janë identifikuar. Veprimtaria kryesore e grupit të organizuar ishte kontrabandimi i kundërligjshëm i migrantëve nga Kosova në vendet e tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) duke fituar në këtë mënyrë përfitime të larta materiale nga aktiviteti i lartë përmendur. Organizata ka mundur të llogarit në një strukturë të organizuar mirë e cila nën udhëheqjen e A.G., në shkëmbim të një shumë të hollash e cila ndryshon nga 3000 në 1500 euro për një migrant, ka marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova në Serbi (për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishin të përfshirë A.H., I.R., S.A., I.K. dhe S.S.) pastaj përmes Serbisë (për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishte përgjegjës J.) dhe pastaj nga Serbia në Hungari (për këtë pjesë të veprimtarisë penale përgjegjës ishte A.G.) dhe prej atje në caqet e përmendura më lart.*

**F.P.** dhe **X.H.** janë

## **SHPALLUR FAJTOR**

*për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, sepse më 14 tetor 2010, në territorin e Kosovës, në atë mënyrë që rrezikuan jetën dhe sigurinë e migrantëve, të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve R.M., V.M., D.M., D.M. 2 and A.M. nga Kosova në Francë; në veçanti F.P. ka bërë ujdishet për çmim të kontrabandimit dhe për transportim jashtë Kosovës të migrantëve dhe është dashur të pranoj 8500 euro nga X.H., i cili ka vepruar si garantues për R.M., me të arritur të migrantëve në cakun e tyre final;*

**B.A.** është

## **SHPALLUR FAJTOR**

*për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë, në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, sepse më 14 tetor 2010, në territorin e Kosovës dhe në territorin e Zvicrës, në atë mënyrë që rrezikoi jetën dhe sigurinë e migrantëve, të përfshirë në kontrabandimin e migrantëve I.A., L.K., A.K., A.K. 2 nga Kosova në Zvicër; në veçanti B.A. ka bërë ujdishet për çmim të kontrabandimit, ka vënë në kontakt migrantët me A.G. dhe është dashur të marrë një pjesë të çmimit të kontrabandimit (që ishte 3000 euro për I.A. dhe 10.000 franga zvicerane për familjen K.) me të arritur të migrantëve në cakun e tyre final;*

**PRANDAJ, të akuzuarit janë**

**DËNUAR**

**S.A.**

*Me shtatëmbëdhjetë (17) vjet burgim dhe një gjobë prej 200.000 euro për veprën penale të Krim i Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274, paragrafi 4 të KPK-së, lidhur me veprën*

***Kontrabandim me Migrantë në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar me paragrafin 1 të KPK-së***

**A.H.**

***Me nëntëmbëdhjetë (19) vjet burgim dhe një gjobë prej 250.000 euro për veprën penale të Krim i Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274, paragrafi 4 të KPK-së, lidhur me veprën Kontrabandim me Migrantë në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së***

**I.K. dhe S.S.**

***Me tetë (8) vjet burgim secili për veprën penale të Krim i Organizuar, në kundërshtim të Nenit 274, paragrafi 2 të KPK-së, lidhur me veprën Kontrabandim me Migrantë në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së***

**F.P.**

***Me shtatë (7) vjet burgim për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë në kundërshtim me Nenin 138 paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së***

**X.H.**

***Me një (1) vjet e gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë, në kundërshtim të Nenit 138, paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së***  
*Në pajtueshmëri me Nenet 41, 42, 43 dhe 44 të KPK-së dënimi kundër X.H. është me kusht dhe prandaj nuk do të ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen ndonjë veprë penale tjetër në periudhën prej tri (3) vjet.*

**Dhe B.A.**

***Me pesë (5) vjet burgim për veprën penale të Kontrabandim me Migrantë, në kundërshtim të Nenit 138, paragrafi 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së***

2. Propozimet për të pushuar paraburgimin të ushtruara nga avokati mbrojtës Shemsedin Piraj në emër të të pandehurit F.P. dhe nga avokati mbrojtës Qerim Zocaj në emër të të pandehurit I.K. **REFUZOHEN** si të pabazuara.

## **ARSYETIMI**

### **I. Historia e procedurës të lëndës**

1. Ngjarja mund të përmblihet me sa vijon: Në natën e 14 tetor 2009, një grup i njerëzve kaluan kufirin në mes të Serbisë dhe Hungarisë me një barkë përmes lumit Tisa afër Suboticës (Serbi). Barka është përmbysur duke rezultuar në vdekjen e pesëmbëdhjetë personave me shtetësi të Kosovës. Tre persona kanë shpëtuar.

2. Aktakuza PPS nr. 422/2009 është ngritur më 13 shtator 2010 nga Prokurori Special duke i akuzuar të pandehurit S.A., F.P., I.K., X.H., S.S., A.H. dhe R.A., me veprat penale të Krim i Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të lexuar me Nenin 23 të KPK-së dhe për Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi

6 të lexuar me Nenin 23 të KPK-së. Më 21 janar 2011 është ngritur aktakuza kundër B.A. duke e ngarkuar atë me të njëjtat vepra penale.

3. Me aktvendimin KA nr. 216/2010, aktakuza është konfirmuar tërësisht.

4. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar në janar 2011 dhe ka përfunduar në qershor 2011. Më 20 janar 2011, trupi gjykues bashkoi procedurën kundër shtatë të pandehurve të përmendur dhe B.A.. Disa dëshmitarë dhe të pandehur janë dëgjuar në gjykatë. Një numër i lartë deklarimesh, raporte të policisë dhe ekspertizës si edhe prova dokumentare janë administruar si prova.<sup>1</sup>

5. Më 17 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka lëshuar aktgjykimin P nr. 244/2010 me të cilin

- A.H. dhe S.A. janë shpallur fajtor për Krim të Organizuar në kundërshtim të Nenit 274 paragrafi 4 të KPK,<sup>2</sup> dhe për Kontrabandim me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim të Nenit 138 paragrafi 6 të lexuar me Nenin 23 të KPK.<sup>3</sup> S.A. ishte dënuar me katërbëdhjetë (14) vite burgim dhe me gjobë prej 200.000 euro për veprën penale të Krimit të Organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 të KPK-së; dhe në dy (2) vite burgim për secilin migrant të kontrabanduar sipas veprës penale të Kontrabandimit të Migrantëve në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së. Dënim unik prej shtatëmbëdhjetë (17) vite burgim dhe gjobë prej 200.000 euro i është shqiptuar atij. A.H. është dënuar me dënim unik prej nëntëmbëdhjetë (19) vite burgim dhe të gjobës prej 250.000 euro.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Shih Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P nr. 244/2010, Aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqet 9-10

<sup>2</sup> “sepse gjatë vitit 2009, deri në tetor 2009, në territorin e Kosovës, në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në veprimtari penale të një grupi të organizuar të përbërë nga vet ata, A.G., I.R., një person me nofkën J., I.K., S.S. dhe njerëz të tjerë që ende janë për tu identifikuar. Veprimtaria kryesore e grupit të organizuar ishte kontrabandimi i kundërligjshëm i migrantëve nga Kosova në vendet e tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) duke fituar në këtë mënyrë përfitime të larta materiale nga aktiviteti i lartë përmendur. Organizata ka mundur të llogarit në një strukturë të organizuar mirë e cila nën udhëheqjen e A.G., në shkëmbim të një shumë të hollash e cila ndryshon nga 3000 në 1500 euro për një migrant, ka marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova në Serbi (për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishin të përfshirë A.H., I.R., S.A., I.K. dhe S.S.) pastaj përmes Serbisë (për këtë pjesë të veprimtarisë penale kryesisht ishte përgjegjës J.) dhe pastaj nga Serbia në Hungari (për këtë pjesë të veprimtarisë penale përgjegjës ishte A.G.) dhe prej atje në caqet e përmendura më lart. Veprimtaritë e grupit të organizuar kanë rezultuar, më 14 tetor 2009, në vdekjen e këtyre migrantëve: E.J., I.A., B.K., F.A., E.A., A.A., F.A., L.K., A.K., A.K. 2, R.M., V.M., D.M., D.M. 2 dhe A.M.’.

<sup>3</sup> Për S.A.: “sepse më 14 tetor 2009, në territorin e Kosovës, duke vepruar si anëtarë i një grupi kriminal dhe në bashkë-kryerje me A.G. dhe të tjerët, në atë mënyrë që rrezikoi jetën dhe sigurinë e migrantëve të angazhuar në kontrabandimin e migrantëve I.A., L.K., A.K., A.K. 2 prej Kosovës në Zvicër, B.K. nga Kosova për në Gjermani; në veçanti S.A. i transportoi migrantët e lartpërmendur në Gjilan ku ata janë marrë nga vozitës tjerë me qëllim që të përcjellën ilegalisht jashtë Kosovës dhe do të duhej të pranonin një pjesë të shumës së kontrabandimit (e cila ishte 3000 euro për secilin për I.A. dhe B.K. dhe 10000 franga zvicerane për familjen Krasniqi) posa që migrantët të arrinin destinacionin e tyre përfundimtarë;”; Për A.H.n: “sepse me 14 tetor 2009, në territorin e Kosovës duke vepruar si anëtarë i grupit kriminal dhe në bashkëkryerje me A.G. dhe të tjerët në mënyrë që rrezikoi jetët dhe sigurinë e migrantëve është angazhuar në kontrabandimin e migrantëve B.R., E.J. dhe dy fëmijëve të tyre, F.A., E.A., A.A., F.A. nga Kosova për në Austri; në veçanti A.H. ka bërë aranzhimet për shumë e kontrabandimit dhe për transportin e migrantëve jashtë Kosovës dhe do të duhej të pranonte shumë për kontrabandim (e cila ishte 6.500 euro për familjen R. dhe 6900 për familjen A.) posa që migrantët të arrinin në destinacionin e tyre përfundimtarë;”

<sup>4</sup> A.H. është dënuar me gjashtëmbëdhjetë (16) vite burgim dhe me gjobë prej 250.000 euro për veprën penale të Krimit të Organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 4 të KPK-së, dhe dy (2) vite burgim për secilin

- F.P. dhe X.H. janë shpallur fajtorë për Kontrabandimin e Migrantëve në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 i lidhur me nenin 23 të KPK-së.<sup>5</sup> F.P. është dënuar me dënim unik prej shtatë (7) vite burgim<sup>6</sup> dhe X.H. është dënuar me dënim me kusht prej dy (2) vite burgim.<sup>7</sup>
- I.K. dhe S.S. janë shpallur fajtorë për Krim të Organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 2 të KPK-së<sup>8</sup> dhe dënuar në tetë (8) vite burgim.
- B.A. është shpallur fajtorë për veprën penale të Kontrabandimit të Migrantëve në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 i lidhur me nenin 23 të KPK-së.<sup>9</sup> Dënimi unik prej pesë(5) vite burgim i është shqiptuar atij.<sup>10</sup>
- Përfundimisht, disa prej të pandehurve ishin të liruar nga akuzat e mbetura. F.P., X.H. dhe B.A. ishin liruar nga veprat penale të Krimin të Organizuar. S.S. dhe I.K. ishin liruar nga veprat penale të Kontrabandimit të Migrantëve në bashkëkryerje. I pandehuri R.A. është liruar nga vepra penale e Krimin të Organizuar dhe të Kontrabandimit të Migrantëve në bashkëkryerje.

6. Trupi gjykues urdhëroi që koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak të akuzuarve të kalkulohet). Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë urdhëroi të akuzuarit që të kompensojnë në mënyrë të përbashkët dhe veçmas shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafin 1 të KPPK-së në shumën e 2.330 eurove.

## II. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

---

migrantë të kontrabanduar sipas veprës penal të Kontrabandimit me Migrantë në bashkë-kryerje në kundërshtim me nenin 138 paragrafin 6 i lidhur me nenin 23 të KPK-së.

<sup>5</sup> “sepse me 14 tetor 2010, në territorin e Kosovës, duke vepruar si anëtarë i grupit penal dhe në bashkë-kryerje me njerëz që duhet të identifikohen, në mënyrë që i ka rrezikuar jetët dhe sigurinë e migrantëve, të angazhuar në kontrabandimin e migrantëve R.M., V.M., D.M., D.M. 2 dhe A.M. nga Kosova për në Francë; në veçanti F.P. i ka bërë aranzhimet për shumën e kontrabandimit dhe për transportin e migrantëve jashtë Kosovës dhe do të duhej të pranoj 8500 euro nga X.H., i cili vepronte si garantues për R.M., sapo që migrantët të arrinin destinacionin e tyre përfundimtarë;”

<sup>6</sup> F.P. është dënuar me dy (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduar sipas veprës penale të Kontrabandimit me Migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

<sup>7</sup> X.H. ishte dënuar me një (1) vit dhe gjashtë (6) muaj burgim për secilin migrantë të kontrabanduar sipas veprës penale të Kontrabandimit me Migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

<sup>8</sup> “sepse prej qershorit deri në shtator të vitit 2009, në territorin e Kosovës, në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në aktivitetet kriminale të grupit të organizuar i përbërë prej tyre, A.G., I.R., personi me nofkën J., A.H., S.A. dhe njerëz tjerë që duhet të identifikohen. Aktiviteti kryesorë i grupit të organizuar ka qenë kontrabandimi ilegal i migrantëve nga Kosova në shtetet tjera të Evropës (kryesisht Francë, Gjermani, Zvicër dhe Austri) kështu duke arritur përfitime enorme materiale nga veprimtaria e mësipërme. Organizata mund të llogariste në një strukturë të organizuar mirë, nën udhëheqjen e A.G., në shkëmbim të shumës së të hollave që ndryshonte prej 3000 deri 1500 euro për migrantë, mbledhjes dhe transportimit të migrantëve nga Kosova në Serbi (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht ishin të përfshirë A.H., S.A., I.R., I.K. dhe S.S.) pastaj nëpër Serbi ( për këtë pjesë të aktivitetit kriminal kryesisht J. ishte përgjegjës) dhe pastaj prej Serbisë në Hungari (për këtë pjesë të aktivitetit kriminal përgjegjës ishte A.G.) dhe pastaj nga atje në destinacionet e lartpërmendura.”

<sup>9</sup> “sepse më 14 tetor 2010, në territorin e Kosovës dhe në territorin e Zvicrës, duke vepruar si anëtarë i grupit kriminal dhe në bashkëkryerje me A.G., S.A. dhe të tjerët, në atë mënyrë që ka rrezikuar jetët dhe sigurinë e migrantëve, është angazhuar në kontrabandimin e migrantëve I.A., L.K., A.K., A.K. 2 prej Kosovës për në Zvicër; në veçanti B.A. ka bërë aranzhimet për shumën e kontrabandimit, i ka vendosur migrantët në kontakt me A.G. dhe ai do të duhej të pranonte pjesën e shumës për kontrabandim (e cila ishte 3000 euro për I.A. dhe 10.000 franga zvicerane për familjen Krasniqi) posa që migrantët e kanë arritur destinacionin e tyre përfundimtarë;”

<sup>10</sup> B.A. është dënuar me (2) vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduar sipas veprës penale Kontrabandimi me Migrantë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së.

## **II. A. Kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës**

7. Gjykata Supreme ka kompetencë të vendos në këtë ankesë në bazë të nenit 26 paragrafit 1 dhe nenit 398 dhe ato vijuese të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 36 të KPPK-së, Ligjit nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë të datës 13 mars 2008, dhe të udhëzuesit të sistemit të caktimit të lëndëve në nivel të Gjykatës Supreme.

## **II. B. Pranueshmëria e ankesave dhe përgjigjeve në ankesa**

8. Aktgjykimi i kontestuar është shpallur më 17 qershor 2011.

- Të gjithë të pandehurit që kanë qenë të paraburgosur në burgun e Dubravës në kohën e pranimit kanë nënshkruar pa datë. Zyrtarët e shërbimit korrektues kanë shënuar 24 tetor 2011 si datë e pranimit. Gjykata Supreme mundet vetëm të supozoj që gjashtë të pandehurit e kanë pranuar aktgjykimin pas 24 tetorit.

- Avokati mbrojtës i S.A., Florin Vertopi e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më datën 21 tetor. Ankesa e tij është regjistruar në shkrimore të gjykatës më 31 tetor.

- Avokati mbrojtës i I.K.t, Qerim Zogaj e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më datën 21 tetor. Ankesa e tij është regjistruar më 1 nëntor.

- Avokati mbrojtës i S.S.t, Ndue Thaqi e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 21 tetor. Ankesa e tij është regjistruar më 1 nëntor.

- Avokati mbrojtës i A.H.t, Bajram Tmava e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 21 tetor. Ankesa e tij është regjistruar më 2 nëntor..

- Avokati mbrojtës i B.A.t, Gezim Kollcaku e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 25 tetor. Ankesa e tij është regjistruar më 10 nëntor.

- Avokati mbrojtës i F.P.t, Shemsedin Piraj e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 24 tetor. Ankesa e tij është regjistruar më 1 nëntor.

Avokati mbrojtës Hilmi Zhitija e ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 21 tetor. Nuk ekziston fletë-kthesë në shkresën e lëndës për të vërtetuar datën pranimit të aktgjykimit nga i pandehuri X.H.. Ankesa është regjistruar në gjykatë më 1 nëntor.

9. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron që ankesat janë marrë parasysh si të pranueshme pasi që janë parashtruar me kohë nga personi i autorizuar në pajtim me nenin 398 paragrafin 1 dhe nenin 399 paragrafin 1 të KPPK-së.

## **II. C. Meritat e parashtresave të palëve**

10. Të gjithë avokatët mbrojtës e gjithashtu edhe i pandehuri S.A. kanë parashtruar ankesat e tyre mbi baza të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së, shkeljeve të ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së, përcaktimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së, dhe në llogari të vendimit mbi sanksionet penale dhe shpenzimeve të procedurës penale. Mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës të ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që të lirojë të pandehurit, ose në mënyrë alternative, të anuloj atë dhe ta kthej lëndën prapa për rigjykim.

11. Më hollësisht, avokati mbrojtës i të pandehurit S.A., Florin Vertopi propozon që Gjykata Supreme e Kosovës të anuloj aktgjykimin dhe të kthej lëndën për rigjykim në bazë të nenit 420 paragrafit 1 pikës 3 të KPPK-së, ose të lirojë atë nga vepra penale Krimi i Organizuar dhe të dënojë atë vetëm për Kontrabandim të Migrantëve në bazë të nenit 420

paragrafit 1 pikës 4 dhe nenit 426 paragrafit 1 të KPPK-së, ose të shqiptojë një dënim më të lehtë në pajtim me nenin 420 paragrafit 1 pikës 4 dhe nenit 406 paragrafit 1 të KPPK-së. Në ankesën e tij, i pandehuri S.A. e pranon përgjegjësinë e tij për veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë në bashkëkryerje dhe shpreh pendimin e tij. Megjithatë, ai e kundërshton akuzën e Krimit të Organizuar e lidhur me veprën penale të Kontrabandimit me Migrantë. Mbrojta e B.A.t propozon që të ndryshohet forma e përgjegjësisë penale d.m.th.: përpjekja dhe të shqiptohet një dënim më i butë.

12. Së fundmi, avokati mbrojtës i të pandehurit F.P., Shemsedin Piraj dhe avokati mbrojtës i të pandehurit I.K., Qerim Zocaj kërkuan që Gjykata Supreme t'i ndërpres paraburgimin F.P.t dhe I.K.t.

## **II. C. 1. Pretendimet e shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së**

### **Pretendimet e shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 8 të KPPK-së**

13. Mbrojtja pretendon shkelje të ligjit të procedurës sipas neneve 153, 154, 156 dhe 259 të KPPK-së i lidhur me nenin 403 paragrafin 1 nën-paragrafin 8 të KPPK-së sepse aktgjykimi është i bazuar mbi faktet e papranueshme. Sipas këndvështrimit të mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë e ka pranuar si provë dëshminë e dëshmitarit M.R. të dhënë në polici edhe pse mbrojtja nuk ka pasur mundësi për ta kundërshtuar. Për më tepër, aktgjykimi i kundërshtuar është i bazuar në provat e marra në kontradiktë me nenet 153 dhe 154 të KPPK-së sepse Urdhri për Përgjimin e Telekomunikimeve të nëntorit 2009 i lëshuar nga Prokurori Special në mënyrë retroaktive është zbatuar e cili është në kundërshtim me nenet 258 dhe 259 të KPPK-së dhe nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).<sup>11</sup>

14. Për më tepër, avokatët mbrojtës të të pandehurve S.S. dhe I.K. pohojnë që mesazhet dhe thirrjet telefonike që pretendohet se janë bërë nga i akuzuari origjinën e kanë nga telefonat të përdorur në restorant nga të gjithë punëtorët.

15. Prokurori i Shtetit parashtron që rregullat e procedurës i japin të drejtë gjykatës të lexojë deklaratën nëse dëshmitari nuk mund të arrihet në bazë të nenit 368 paragrafit 1 të KPPK-së dhe që neni 156 i KPPK-së është i aplikueshëm vetëm nëse dëshmitari është i arritshëm. Veç kësaj, Prokurori i shtetit konsideron që pretendimi lidhur me retroaktivitetin e përgjimit të telekomunikimeve pa meritë, pasi që ligji nuk parandalon administrimin e provave sipas periudhës së caktuar kohore.

16. Gjykata Supreme i refuzon si të pabazuar pretendimet e mbrojtjes lidhur me këtë. Është vërejtur që seancat dëgjimore të dëshmitarit janë mbajtur pa praninë e të akuzuarve dhe të avokatëve të tyre mbrojtës, dhe mbrojta nuk ka pasur mundësi më vonë që nënrye adekuate dhe efektive të kundërshtoj këto prova.<sup>12</sup> Për të arsyetuar pranueshmërinë e deklaratave të M.R., gjykata e shkallës së parë ka vendosur “sa i përket deklaratave të dhëna

<sup>11</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Fundamentale të datës 4 nëntor 1950

<sup>12</sup> Shih dosjen e kaltër lënda TISA për gjyqtarin dosja I OCHTB, deklarata e dëshmitarit M.R. e datës 10 nëntor 2009 të dhëna në polici; Dosja e kaltër lënda TISA dosja I – deklaratat e dëshmitarëve – aktakuza OCHTB I, deklarata e dëshmitarit M.R. e datës 14 maj 2010 e dhënë tek Prokurori



nga M.R., se ato janë marrë pa miratimin e palëve në bazë të nenit 368 par. 1, pikës 1 të KPPK-së.”<sup>13</sup>

17. Siç është ngritur me plotë të drejtë nga mbrojtja, pranueshmëria e deklaratave të tilla të dëshmitarit gjithashtu përcaktohet në pajtim me procedurën me nenin 156 paragrafin 2 të KPPK-së: “Deklarata e dëshmitarit e dhënë para policisë ose prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm nëse i pandehuri ose avokati mbrojtës i është dhënë mundësia të kundërshtoj atë duke e marrë në pyetje dëshmitarin gjatë ndonjë faze të procedurës penale.” Kjo e siguron respektin e parimit të drejtpërdrejtë të provës dhe të standardeve të gjykimit të drejtë, posaçërisht të drejtat e mbrojtjes. Ky nen, megjithatë, nuk përbën një ndalesë absolute për pranueshmërinë e secilës provë të paraqitur nga prokuroria ose e përdorur sipas detyrës zyrtare nga gjykata për vërtetimin e së vërtetës. Edhe pse disa elemente të sistemit të ligjit zakonor janë inkorporuar në KPPK, kjo qëndron se roli dominues i organeve gjyqësore në sistemin e ligjit civil të cilit i takon sistemi gjyqësor i Kosovës, është të vërtetojë të vërtetën (parimi i hetimit gjyqësor). Kjo shprehet në nenin 46 paragrafin 3 të KPPK-së duke theksuar që prokurori publik ka detyrë të konsiderojë provat shfajësuese dhe faktet gjatë hetimit të veprës penale dhe të sigurojë që hetimi të zhvillohet me respekt të plotë për të drejtat e të pandehurit. Kjo gjithashtu është e nënvizuar nga neni 386 paragrafit 2 të KPPK-së.<sup>14</sup>

18. Kodi i Procedurës përmban edhe një dispozitë tjetër duke e shpjeguar rregullën e nenit 156: Neni 368 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 i KPPK-së i cili parashikon që” Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për veprë penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste: 1) Kur personat e marrur në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme”

19. Trupi gjykues, edhe pse ka ofruar arsyetim konciz në këtë çështje, ka bërë adresimin e kësaj dispozite dhe të aktvendimit të saj të datës 14 prill 2011.<sup>15</sup> Kolegji i Gjykatës së Qarkut ka tentuar të kontaktoj dëshmitarin, megjithatë ky i fundit nuk ka qenë i arritshëm.<sup>16</sup> Kështu që trupi gjykues bazuar në nenin 386 të këtij Kodi, vendimin e tij për të lexuar të dhënat e dëgjimit të dëshmitarit M.R., për shkak se të gjitha përpjekjet për ta sjellë atë në gjykatë ishin të pasuksesshme. Kjo rrethanë arsyeton përdorimin deklaratave të dëshmitarit si përjashtim të dispozitës së përgjithshme të nenit 156 të Kodit që Gjykata Supreme e konsideron të arsyeshme për të vërtetuar të vërtetën.

20. Për më tepër, Kolegji i Gjykatës Supreme, konstaton të pa meritë pohimin e mbrojtjes lidhur me pranueshmërinë e përgjimit të telekomunikimeve të nxjerra me urdhrin e Prokurorit Special.

<sup>13</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P nr. 244/2010, aktgjykimi shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqe 10

<sup>14</sup> Neni 386 paragrafi 2 i KPPK-së: “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e paditësit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.”

<sup>15</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, Aktgjykim i gjykatës së shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqe 10, fusnota 1

<sup>16</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 14 prill 2011, faqet 3-4: “në seancën e fundit dëgjimore palëve u është ofruar deklaratat që thekson që gjykata nuk mund të kontaktoj M.R., i cili aktualisht është duke jetuar në Zvicër dhe nuk ka adresë të njohur atje ....”

21. Me të vërtetë është vërejtur që disa urdhra janë lëshuar për masa të fshehta në formë të përgjimeve të telekomunikimeve dhe regjistrimit të thirrjeve telefonike, nga prokurori ose nga gjyqtari i procedurës paraprake.<sup>17</sup> Më tutje është vërejtur që shumica e urdhrave për regjistrimin e thirrjeve telefonike janë ‘mbuluar’ nga urdhrat pasues për përgjimin e telekomunikimeve të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake. Sipas këndvështrimit të kolegjit, duket se konfuzioni ngritët në mes të regjistrimit të thirrjeve telefonike dhe të përgjimit të telekomunikimeve. Përderisa regjistrimi i thirrjeve telefonike që ka të bëjë me të dhënat e thirrjeve telefonike, p.sh. numrat e përdorur telefonik, data dhe kohëzgjatje e thirrjeve telefonike, urdhërohet nga prokurori, masat e fshehta në formë të përgjimit të telekomunikimeve, më tepër pushtuese, mundet të zbatohet vetëm me urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake në pajtim me nenin 258 paragrafin 1 dhe 2 të KPPK-së. Analizat e rezultateve të zbatimit të këtyre masave të fshehta konstatojnë që të dyja autoritetet gjyqësore, prokurori dhe gjyqtari i procedurës paraprake, kanë lëshuar urdhra në pajtim me ligjin.

22. Në nenin 259 paragrafin 1 nën-paragrafin 4 të Kodit specifikohet se urdhri për ndonjë masë të fshehtë zbatohet brenda 60 ditësh nga dita e marrjes së urdhrin. Duket se urdhrat e lëshuar nga prokurori special ishin zbatuar brenda këtij afati kohor, siç vërtetohet edhe me dëftesat e PTK-së dhe të dhënat e IPKO-s.<sup>18</sup> KPPK-ja nuk përmban asnjë dispozitë që ndalon zbatimin retroaktiv të urdhrin për masa të fshehta. Kolegji i Gjykatës Supreme i bashkohet arsytimit të gjykatës së shkallës së parë se neni 258 i KPPK-së nuk bën asnjë dallim në mes telekomunikimeve në zhvillim e sipër dhe atyre që tanimë janë kryer. Në koncept, thirrjet telefonike mund të përgjohen vetëm më vonë. Prandaj rezultatet e këtyre masave nuk janë prova të papranueshme për shkak të retroaktivitetit të këtyre masave. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka identifikuar asnjë shkelje të neneve 258 dhe 259 të Kodit dhe/ose neneve 5 dhe 6 të KEDNj-së, dhe konsideron se ligji dhe praktikat e gjyqësorit të Kosovës janë në përputhje me standardet Evropiane.<sup>19</sup>

<sup>17</sup> Shih *inter alia* dosja e GjQ Prishtinë, EULEX PPS nr. 422/09, GJPP nr. 297/09 akuzat e LËNDËS TISA, dosja I e procedurës paraprake, fillimi i hetimeve 23/10/2009: urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake GJPP nr. 297/2009 i datës 24 nëntor 2009 për përgjimin e mesazheve të numrit të telefonit 049 743 543 që i takon S.A. prej datës 01.08.2009 dhe 16.11.2009; dosja e kaltër PPS nr. 422/09 lënda TISA dosja I urdhrat e GjQ Prishtinë, II, OCTHB: Urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake GJPP nr. 297/2009 i datës 24 gusht 2010 për përgjimin e të dhënave dhe të thirrjeve telefonike 044 260 626 dhe 044 117 924 që i takojnë S.S.t dhe I.K.t për një periudhë 60 ditore; dosja ngjyrë hiri, office line, Shkresat në Prokurori: Urdhri i SPRK-së i datës 5 nëntor 2009 për masat e fshehta (regjistrimi i thirrjeve telefonike në numrat e telefonit 044 137 206 dhe 044 661 892) që i takojnë S.A. për thirrjet telefonike të bëra nga data:01.08 2009 deri më 23.10.2009; Dosja EULEX GjQ Prishtinë GJPP 297/09 Tisa IV prej datës 07/06/2010: Urdhri i gjyqtarit të procedurës paraprake GPJJ nr. 297/2009 të datës 24 gusht 2010 të përgjimit të telekomunikimeve ( thirrjet telefonike dhe mesazhet) kundër S.S.t dhe I.K.t (044 260 626 dhe 044 117 924) nga data 01.06 deri më 16.11 2009.

<sup>18</sup> Shih në mes tjera letrën e PTK-së me numër referues PTK-ZKL nr. 1015/09 të datës 6 nëntor 2009 për numrat e telefonit 044 137 206 dhe 044 661 892

<sup>19</sup> Shih në mes tjera praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) mbi përgjimet e telekomunikimeve dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare nga neni 8 i KEDNj-së: “1 Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2 Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”; shih KEDNj, lënda Kennedy kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 26839/05, Aktgjykimi, 18 maj 2010: “151. Kushti që secila ndërhyrje duhet të jetë “në pajtim me ligjin” nga neni 8 § 2 do të plotësohet vetëm kur plotësohet tri kushte. I pari, masa e kundërshtuar duhet të jetë e bazuar në ligjin vendor. I dyti, ligji vendor duhet të jetë i pajtueshëm me sundimin e ligjit dhe personat përkatës të kenë qasje në të. I treti, personi i prekur duhet të jetë në gjendje t’i parashih pasojat e ligjit vendor për të (shih, në mes shumë autoriteteve të tjera, *Rotaru kundër Rumanisë*, cituar më lart, § 52; *Liria dhe të Tjerët*, cituar më lart, § 59; dhe *Iordachi dhe të Tjerët*, cituar më lart, § 37).” 152. Gjykata në disa raste ka konsideruar se lidhja e “parashikueshmërisë” në konceptin e përgjimit të

23. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron njësoj se pretendimi i avokatit mbrojtës të S.A. është jomeritor lidhur me refuzimin e propozimit të datës 7 prill 2011. Nga procesverbali i gjykimit, vërehet se trupi gjykues refuzoi propozimin e mbrojtjes për shpalljen të papranueshme të ekstrakteve të porosive SMS, dhe raporteve të policisë lidhur me to pasi që ishin siguruar pas lëshimit të urdhrave të prokurorit.<sup>20</sup> Prapë, Kolegji i Gjykatës Supreme mendon se ligji nuk i ndalon masatë e fshehta të tilla dhe sa i përket kësaj i referohet gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë.<sup>21</sup>

24. Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se kundërshtimi i mbrojtjes është i pabazuar se telefonat të cilët pretendohet se i takojnë S.S.t dhe I.K.t mbi të cilat është bërë ekstraktimi i mesazheve dhe thirrjeve telefonike, ishin përdorur në një restorant nga persona të tjerë përveç të pandehurve. Ky vlerësim i fakteve nuk qëndron siç edhe potencohet me të drejtë në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë mbi përkatësinë e këtyre telefonave celularë.<sup>22</sup> Analiza e të dhënave të nxjerra tregon se të pandehurit kishin rol aktiv në organizimin kriminal. Vlen të përmendet se Kolegji i Gjykatës Supreme po ashtu përdori këtë dëshmi për shfajësimin e të pandehurve për veprën penale të kontrabandimit me migrantë.

### **Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 paragrafi 1 nën-paragrafi 10 i KPPK-së**

25. Mbrojtja pretendon se shkelja e nenit 386 paragrafit 1 të KPPK-së<sup>23</sup> lidhur me nenin 403 paragrafin 1 nën-paragrafin 10 të KPPK-së bëhet kur aktgjykimi i shkallës së parë

---

telekomunikimeve nuk mund të jetë i njëjtë sikur në shume fusha të ndryshme (shih *Malone*, cituar më lart, § 67; *Leander kundër. Suedisë*, 26 mars 1987, § 51, Seria A nr. 116; *Shoqata për Integritim Evropian*, cituar më lart, § 79; dhe *Al-Nashif*, cituar më lart, § 121). Në vendimin për pranueshmërinë në *Weber dhe Saravia*, cituar më lart, §§ 93 to 95, Gjykata përmbodhi praktikatat gjyqësore të saj mbi kushtin e “parashikueshmërisë” në këtë fushë: “93. ... parashikueshmëria në kontekstin e veçantë të masave të fshehta të vëzhgimit, sikurse përgjimi i telekomunikimeve, nuk nënkupton se individit duhet të jetë në gjendje ta parashohë kur organet do t’i përgjojnë telekomunikimet e tij që ai të sillet në përputhje me rrethanat (shih, *në mes tjera, Leander [kundër. Suedisë]*, aktgjykimi i datës 26 gusht 1987, Seria A nr. 116], f. 23, § 51). Megjithatë, rreziqet e arbitraritetit janë evidente posaçërisht kur autoriteti i ekzekutivit ushtrohet në fshehtësi (shih, *në mes tjera, Malone*, cituar më lart, f. 32, § 67; *Huvig*, cituar më lart, faqet. 54-55, § 29; dhe *Rotaru*). [...] Ligji vendor duhet të jetë mjaft i qartë që qytetarëve t’u jep indikacion të qartë lidhur me rrethanat dhe kushtet mbi të cilat autoritetet publike kanë kompetencë për ushtrimin e masave të tilla (shih *Malone*, ibid.; *Kopp*, cituar më lart, f. 541, § 64; *Huvig*, cituar më lart, faqet. 54-55, § 29; dhe *Valenzuela Contreras*, ibid.).

<sup>20</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 7 prill 2010, faqe 24

<sup>21</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqet 63-64

<sup>22</sup> Ibid, faqe 50 për të pandehurin S.S.: “S.S. pranoi se numri 044 260 626 ishte numri i telefonit të tij dhe se, megjithëse telefoni i tij mobil ishte po ashtu në dispozicion të punëtorëve të kompanisë gjatë orarit të punës ai iku bashkë me I.K.n, numri i lartpërmendur i telefonit përdorohej më së shumti nga vetë ai. Dhe se S.S. ishte personi që përdorte numrin e përmendur shumicën e kohës vërtetohet me faktin se në disa mesazhe atë e thërrisnin me emrin (Shaip); përveç kësaj vlen të përmendet se shumë nga këto mesazhe ishin këmbyer në mbrëmje vonë, pas orarit të punës, atëherë kur punëtorët e kompanisë nuk kishin mundësi ta përdornin telefonin mobil.”; shih faqet 54-55 për të pandehurin I.K.: “I.K. pranoi se numri 044 117 924 ishte numri i telefonit të tij, edhe pse pretendon se telefoni i tij mobil ishte po ashtu në shfrytëzim të punëtorëve të kompanisë të cilën ai e udhëhiqte, pasi që e linte telefonin e tij mobil në lokalet e kompanisë së tij. Vlen të përmendet se versioni i lartpërmendur që e dha Ismaili duket i papranueshëm dhe i pabesueshëm. Në fakt, pasi që ai ishte ndërmarrës ai kishte nevojë të jetë në kontakt (ai nuk kishte numër tjetër): prandaj ka shumë pak gjasa që, përveç në disa raste të rralla, ai nuk e kishte marrë telefonin mobil me vete pasi kishte dalë nga vendi i tij i punës. Përveç kësaj...”

<sup>23</sup> Neni 386 paragrafi 1 i KPPK-së: “(1) Aktgjykimi mund t’i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor.”; Krahaso me nenin 376 paragrafin 1 të KPPK-së mbi ndryshimet dhe zgjerimin e aktakuzës që përshkruan paditësi për ngritjen e aktakuzës së ndryshuar nëse provat tregojnë se gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë ka ndryshuar

tejkalon aktakuzën. Sipas mbrojtjes, trupi gjykues nuk arriti ta ruajë identitetin e përshkrimit faktik të aktakuzës.

26. Shënohet se aktakuza PPS nr. 422/09 e ngritur më 13 shtator 2010 jep përshkrimin faktik si në vijim:

“në datë të panjohur në natën mes 14 dhe 15 tetorit 2009, duke vepruar si grup të strukturuar, me qëllim të përfitimit material financiar, duke rrezikuar jetën dhe sigurinë e migrantëve, në bashkëpunim me të pandehurin B.A., A.G. – K. dhe I.R. të cilët janë në arrati, kanë kontrabanduar shtetasit e Republikës së Kosovës, duke gjetur migrantë të interesuar të dalin në vende të ndryshme të Evropës, pas marrëveshjes për çmimin migranti duhej të paguante shumën prej 3000 eurosh për person, ose 6300 euro deri 8000 euro për familje, pastaj në mënyrë të paligjshme, përmes personave të ndryshëm në Serbi ata i dërguan migrantët matanë lumit Tisa që gjendet në kufirin mes Serbisë dhe Hungarisë, afër qytetit të Suboticës në Serbi, në vende të ndryshme të Evropës, por natën në mes 14 dhe 15 tetorit 2009 një pjesë e migrantëve të kontrabanduar ishin vendosur në një varkë për ta kaluar lumin Tisa, dhe varka me 18 migrantë u përmbyt dhe prej 18 migrantëve 15 gjetën vdekjen: E.J., I.A., B.K., F.A., E.A., A.A., F.A., L.K., A.K., A.K. 2, R.M., V.M., D.M., D.M. 2 dhe A.M., kurse tre migrantët B.R., R.J. dhe E.J. arritën i shpëtuan vdekjes, kurse pala e dëmtuar M.R. me familje para se të arrinin te kufiri i Serbisë me Hungarinë bashkë me një grup tjerët prej 20 migrantëve, ndërroi mendje dhe u kthye në Kosovë me familjen e tij.”

27. Kolegji i Gjykatës Supreme, përveç se nuk mbështet aspak zgjerimin e aktakuzës, mendon se dispozitivi përmban përshkrim më të saktë dhe më preciz faktik se përshkrimi i përmendur në aktakuzë. Në të vërtetë, trupi gjykues në dispozitiv jep detaje shtesë mbi shtrirjen kohore të kryerjes së veprave penale,<sup>24</sup> mbi sferën gjeografike të veprave të kryera,<sup>25</sup> dhe mbi mjetet e kryerjes së veprave penale.<sup>26</sup> Kolegji i Gjykatës së Qarkut po ashtu e individualizon gjendjen faktike të dispozitivit për secilin të pandehur. Në thelb faktet mbesin të njëjta si në aktakuzë. Prandaj trupi gjykues e kishte ruajtur identitetin e përshkrimit faktik, pa dalë përtej nenit 386 paragrafit 1 të KPPK-së.

28. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e mbrojtjes lidhur me ndryshimin e emërtimit ligjor të krimit të organizuar nga neni 274 janë jomeritore përkitazi me të pandehurit I.K. dhe S.S.. Gjykata e shkallës së parë vërtetë procedoi me ndryshimin e cilësimit juridik nga paragrafi 4 te paragrafi 2 i nenit 274 të KPPK-së.

29. Trupi gjykues, kur procedon me ri-cilësim nga neni 386 i KPPK-së, duhet patjetër të garantojë se i akuzuari do të njoftohet me kohë për atë ndryshim, si pjesë e të drejtës për t'u informuar drejt për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, dhe të ketë “kohë dhe lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes”. Këto të drejta dalin nga disa dispozita të Kodit, nga

<sup>24</sup> Shih, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqe 3: “përgjatë vitit 2009, deri në tetor 2009”; faqet 3 dhe 4: “më 14 tetor 2009”; faqe 4: “nga qershori deri në shtator 2009”.

<sup>25</sup> Ibid, faqet 3 dhe 4: “në territorin e Kosovës,”; “në territorin e Kosovës dhe në territorin e Zvicrës,”

<sup>26</sup> Ibid, mbi përbërjen dhe veprimtaritë e grupit të organizuar kriminal (vepra penale e krimit të organizuar): faqe 3 “një grup i organizuar i përbërë nga, A.G., I.R., një personi me nofkën J., I.K., S.S. dhe persona të tjerë ende të paidentifikuar.”; “Aktiviteti kryesor i grupit të organizuar ishte kontrabandimit ilegal me migrantë nga Kosova për në shtetet e tjera të Evropës [...] kanë marrë dhe transportuar migrantët nga Kosova në Serbi ... pastaj nëpër Serbi ... dhe pastaj nga Serbia në Hungari ... dhe më pas prej aty deri në vendet e përmendura më lart.”; mbi mjetet e kontrabandimit me migrantë, faqe 3: “prej Kosovës në Zvicër, B.K. “prej Kosovës në Gjermani..”; faqe 4: “prej Kosovës në Austri;”; faqe 5 “prej Kosovës në Francë”; mbi përfitimin material të të pandehurve, faqe 3: “në këmbim të shumës së parave që shkon prej 3000 deri në 1500 Euro për një migrant”; faqe 4 : “për të marrë një pjesë të shumës së kontrabandimit (që ishte 3000 Euro për secilin për I.A. dhe B.K. dhe 10000 Franga Zvicerane për familjen K.)”

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga KEDNj.<sup>27</sup> KEDNj-ja ka krijuar një strukturë të garancive minimale për gjykim të drejtë me nenin 6 të KEDNj-së.<sup>28</sup>

30. Kolegji i Gjykatës së Qarkut jep një arsyetim shumë të ngjeshur mbi këtë pikë.<sup>29</sup> Kolegji i nënshkruar, megjithatë, shënon se paragrafi 4 ka të bëjë me rrethanat rënduese me rastin e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 2 i KPK-së. Gjykata Supreme, me vlerësimin e korrektësisë së procedurës në tërësi, arrin në përfundim se të pandehurit I.K. dhe S.S. kishin kohë të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes së tyre pasi emërtimet ligjore nën këto dispozita janë shumë të ngjashme, të mos përmendim rrethanat rënduese nën paragrafin 4. Përveç kësaj vërehet se paragrafi 2 është më i favorshëm për të pandehurit. Ndryshimi i emërtimit ligjore pra ishte bërë në përputhje me nenin 386 paragrafin 2 të KPPK-së. Prandaj Kolegji i Gjykatës Supreme këtë bazë të ankesës e refuzoi si të pabazuar.

31. Në fund, Gjykata Supreme nuk e sheh se si mund të jetë bërë shkelje nga neni 403, paragrafi 1 nën- paragrafi 11 lidhur me nenin 417 të KPPK-së në fazën e shqyrtimit gjyqësor, dhe rrjedhimisht e refuzon këtë bazë të ankesës.

### **Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 paragrafi 1 nën-paragrafi 12 i KPPK-së**

32. Mbrojtja pretendon në shkelje të nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 të KPPK-së sepse dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës në brendi: nuk ka specifikim të kornizës kohore të kryerjes së veprave penale,<sup>30</sup> numrit të migrantëve të kontrabanduar dhe modaliteteve të kontrabandimit. Për më shumë, gjykata e shkallës së parë nuk arriti të sigurojë një analizë të hollësishme të fakteve vendimtare dhe të elementeve të krimit. Veçanërisht, avokati mbrojtës i X.H. pretendon se Kolegji i Gjykatës së Qarkut ka bërë shkelje të nenit 1 të KPPK-së dhe nuk i ka përmendur veprat inkriminuese të cilat i ka kryer i pandehurit në dispozitiv.

33. Në vazhdim mbrojtja pretendon se sa i përket fakteve materiale, ekziston një mospërputhje e konsiderueshme në mes arsyetimit përkitazi me përmbajtjen e procesverbalit në njërën anë, dhe vetë procesverbalit në anën tjetër. Parimisht, avokati mbrojtës Bajram Tmava pretendon në kundërthëniet e rolit të A.H.t si personi kryesor në grupin e organizuar. Avokati Shemsedin Piraj pretendon se aktgjykimi nuk përmban asnjë element mbi ekzistimin e bashkëkryerjes në mes të F.P.t dhe X.H.. Mbrojtja po ashtu parashtron se gjykata e shkallës së parë nuk arriti të përcaktojë dashjen specifike të të pandehurve për të kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë siç kërkohet me nenin 138 paragrafin 6 të KPK-së.

<sup>27</sup> Shih në mes tjera nenet 12, 30, 214 dhe nenin 231 të KPPK-së; nenin 30 të Kushtetutës së Kosovës; nenin 6.3 të KEDNj-së

<sup>28</sup> Lënda KEDNj, Pelissier dhe Sassi kundër. Francës, Kërkesa nr. 25444/94, Aktgjykimi i datës 25 mars 1999, par 51 al fine: “Neni 6 § 3 (a) i Konventës i siguron të pandehurit të drejtën të njoftohet jo vetëm për shkakun e akuzës, pra për veprat të cilat pretendohet se i ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuzat, por edhe për karakterizimin ligjor të atyre veprave.”; Gjykata Supreme e Kosovës, Pkl - Kzz nr. 61/2011, Aktgjykim mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 10 tetor 2011, faqe 5 dhe 6

<sup>29</sup> Shih, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, Aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqe 62: “Pra, sa i përket I.K.t dhe S.S.t, cilësimi i prokurorit nuk duket të jetë i drejtë dhe akuzat penale duhet të ri-cilësohet nga neni 274, par. 4 i KPK-së në nenin 274, par. 2 të KPK-së. Pas ri-cilësimit të akuzës, provat e paraqitura kundër dy të pandehurve të përmendur tregojnë pamohueshëm ekzistimin e *actus reus* dhe të *mens rea* përkitazi me veprën e lartpërmendur penale.”

<sup>30</sup> Fusha e përshkrimit faktik e cila në aktakuzë ishte fillimisht ‘prej 14 deri më 15 tetor 2009’ në dispozitiv u zgjerua ‘prej qershorit deri në shtator 2009’

34. Prokurori i Shtetit parashtron se pretendimi për shkelje të dispozitave të procedurës penale të nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 të KPPK-së nuk qëndron.

35. Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se janë të pabazuara pretendimet se dispozitivi është i pakuptueshëm. Dispozitivi jep përshkrim të qartë dhe të kuptueshëm të fakteve vendimtare.<sup>31</sup> Aktgjykimi i kundërshtuar inkorporon tërë përmbajtjen e procesverbaleve nga shkresat e lëndës që nuk le asnjë dyshim sa i përket përgjegjësinë penale të të pandehurve. Gjykata Supreme është e mendimit se nuk ka mospërputhje në mes fakteve në dispozitiv dhe përmbajtjes së dëshmive të dëshmitarëve. Dispozitivi i lexuar së bashku me arsyetimin e detajuar të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të provave si dhe një vërtetim të saktë të gjendjes faktike. Në pikëpamjen e Gjykatës Supreme, janë konstatuar të gjitha elementet e veprës penale të krimit të organizuar dhe të kontrabandimit me migrantë si dhe është vërtetuar përgjegjësia penale e secilit të pandehur, sidomos faktet vendimtare.<sup>32</sup>

36. Gjykata Supreme e Kosovës po ashtu refuzon parashtrësën e prezantuar lidhur me të pandehurin X.H., pasi që dispozitivi e përmend në mënyrë të qartë veprën e kryer nga i pandehuri si dhe rolin e të njëjtit ‘duke vepruar si garantues për R.M.’, si një formë të përgjegjësisë si dhe mënyrën e kryerjes. Dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të kontestuar madje përmbajnë edhe dëshmitë e të pandehurit.<sup>33</sup> Anëtarët e kolegjit të nënshkruar më poshtë nuk shohin asnjë shkelje të nenit 1 të KPPK-së.

37. Sa i përket pohimit se trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut nuk ka përmendur qëllimin specifik të të pandehurve për të kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë, Gjykata Supreme duket se pajtohet me parashtrësat e mbrojtjes. Neni 138 i KPK-së, paragrafi 7, pika 1, përkufizon shprehjen “kontrabandim me migrantët” në këtë mënyrë: “prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore a financiare i një hyrjeje të paligjshme të personit në Kosovë, i cili nuk është banor i Kosovës ose në shtetin në të cilin personi nuk është banor i përhershëm apo shtetas i huaj.” Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përcakton si element të krimit që vepra të kryhet “prokurim me qëllim të fitimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi të një dobie pasurore”.

38. Vërejmë se në dispozitivin e shkallës së parë përmendet çmimi i kontrabandimit për secilin migrant si dhe mënyrën e pagesës. Formulimi i përdorur është si në vazhdim: për shembull, “pasi migrantët të kenë arritur në destinacionin e tyre përfundimtar, ai do ta merrte një pjesë të çmimit të kontrabandimit (i cili ishte 3000 euro për I.A. ndërsa 10000 franga zvicerane për familjen K. pasi migrantët në fjalë të kishin mbërritur në destinacionin e tyre përfundimtar;”. Kolegji i Gjykatës Supreme, prandaj pranon se qëllimi specifik është dashur të shprehet në mënyrë më të qartë në dispozitivin në fjalë.

39. Ajo çfarë është shumë shqetësuese për Gjykatën Supreme është arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me qëllimin specifik: “është parim i përgjithshëm se edhe pse krimi kërkon dashjen e posaçme (*dolus specialis*), ndërsa krimi i përcaktuar me nenin 138 të KPK-së kërkon qëllimin e posaçëm të kontrabandimit me migrantë me qëllim të fitimit të një dobie pasurore (prandaj qëllimi i posaçëm i cili shkon përtej rezultatit të sjelljes së vepruesit),

<sup>31</sup> Shih në mes tjerë Arsyetimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me pretendimet për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 paragrafi 1 nën-paragrafi 10 i KPPK-së, paragrafi 25 e tutje

<sup>32</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244 / 2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, pjesa 2.5. Ekzistimi i një grupi të organizuar i cili merret me kontrabandim, faqe 39 e tutje

<sup>33</sup> Po aty, pjesa 2.2.6. Kontrabandimi i familjes M., faqe 31 e tutje dhe pjesa 3. Cilësimi juridik, faqe 60 e tutje

mjafton që së paku njëri nga pjesëmarrësit në veprën penale (në qoftë se krimi është kryer në bashkëkryerje) të ketë pasur qëllimin e nevojshëm të posaçëm, ndërsa të tjerët mund të kenë pasur qëllimin e përgjithshëm për të dhënë kontributin e tyre të vetëdijshëm për kryerjen e krimit.”<sup>34</sup>

40. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, elementi subjektiv, qëllimi për të kryer veprën penale është kusht themelor për një vepër penale, së bashku me *actus reus* dhe elementin ligjor. Ligji penal përcakton që veprat e caktuara penale kërkojnë dashjen shtesë. Duke shfletuar dispozitat përkatëse, qëllimi i ligjvënësit ashiqare ka qenë përfshirja e parimit *dolus specialis* si një nga kushtet e veprës kontrabandim me migrantë. Kjo është në përputhje të plotë me kornizën ndërkombëtare ligjore.<sup>35</sup> Gjykata Supreme konsideron se dashja në përgjithësi si dhe *dolus specialis* në veçanti është një element i domosdoshëm për vërtetimin e përgjegjësisë penale të secilit të akuzuar. Dashja është e brendshme për kryerësin dhe si e tillë nuk mund të “bartet” nga një i pandehur tek tjetri. Konstatimet e gjykatës së shkallës së parë që provat se një nga të pandehurit kishte *dolus specialis* mjaftojnë për të treguar se dashja e të tjerëve është si pasojë e gabuar. Megjithatë, ky kolegji konsideron se nga leximi i përbashkët i dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit,<sup>36</sup> del e qartë se të gjithë të pandehurit e dënuar për kontrabandim me migrantë, pra të pandehurit Shpejtim Ademaj, A.H., F.P., X.H. dhe B.A. kanë vepruar me këtë dashje specifike për fitimin e dobisë pasurore. Ata kanë kryer veprën penale në fjalë dhe kanë fituar para nga e njëjta apo kanë pritur të fitojnë dobi pasurore nga vepra. Duke u nisur nga kjo arsye, kjo pikë e ankesës refuzohet si e pabazë.

## **Pohimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, par. 2 të KPPK-së**

41. Avokati mbrojtës Bajram Tmava për të pandehurin A.H. pohon se ka pasur shkelje esenciale të procedurës penale të përcaktuar me nenin 403, par. 2, nënpar. 1 dhe 2, lidhur me nenin 7, par. 1 dhe nenin 2, par. 2 të KPPK-së, të kryera nga ana e prokurorit dhe kolegjit, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka pranuar prova në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Ai po ashtu pretendon se trupit gjykues i mungonte objektiviteti nga fakti se kryetari i trupit gjykues po intervenonte përderisa dëshmitarët po merreshin në pyetje nga ana e prokurorisë apo

<sup>34</sup> Shih *inter alia* po aty, faqet 60 - 61

<sup>35</sup> Shih *inter alia* Protokollin kundër kontrabandimit me migrantë përmes rrugëve tokësore, detare dhe ajrore, si plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërshtetëror, të miratuar më 15 nëntor 2000, neni 3: “për qëllime të këtij protokollit: (a) “Kontrabandimi me migrantë” do të thotë prokurimi, me qëllim të fitimit të dobisë financiare apo pasurore qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, nga hyrja e kundërligjshme e një personi në palën shtetërore në të cilën personi nuk është shtetas apo banor i përhershëm; [...]”; shih udhëzimet legjislative për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërshtetëror si dhe protokolleve të saj, të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për narkotikë dhe krim, divizionit për çështje të marrëveshjeve, Nju Jork 2004, pjesa e tretë, II. Detyrimet specifike të protokollit, A. Përkufizimi dhe penalizimi i kontrabandimit me migrantë, faqe 342: “35. Siç është thënë më lart, standardi i përgjithshëm i Konventës dhe i protokolleve të saj për veprat penale është se të njëjtat duhet të jenë kryer qëllimisht. Kur kemi të bëjmë me veprën e kontrabandimit, kjo gjë imponon dy kushte: duhet patjetër të ketë ekzistuar një qëllim primar për të prokuruar hyrjen e kundërligjshme dhe duhet të ketë ekzistuar qëllimi i dytë, pra ai i fitimit të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.”

<sup>36</sup> Shih *inter alia* Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244 / 2010, faqe 39: “Ky grup i organizuar kriminal mund të llogariste në një strukturë solide me bazë kryesisht në Kosovë dhe në Serbi (por jo vetëm në këto dy shtete), e cila për një shumë në kundërvlerë prej 3000 deri në 1500 eurosh për migrant, kanë mbledhur dhe kanë transportuar migrantët nga Kosova për Serbi, pastaj përmes Serbisë për në Hungari dhe prej aty për në shtetet e përmendura më lart.”; faqe 44 e tutje: “Shifrat e përmendura më lart janë shokuese dhe të japin idenë e dimensioneve të kontrabandimit në fjalë, nëse konsiderojmë që çmimi për migrant të kontrabanduar ka qenë 3000 euro për çdo person të rritur ndërsa 1500 euro për çdo fëmijë më të ri sesa 12 vjeç” faqe 59 e tutje lidhur me cilësimin juridik.

mbrojtjes, në kundërshtim me nenin 165, par. 2 të KPPK-së. Duke iu përgjigjur këtij pretendimi, prokurori i shtetit deklaroi se në kuptim të nenit 360, par. 5 të KPPK-së, trupi gjykues ka të drejtën e shqyrtimit të provave të cilat i konsideron si të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të lëndës.

42. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka identifikuar asnjë shkelje të ligjit të procedurës për shkak të faktit se trupi gjykues i shkallës së parë ka pranuar prova në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Duke supozuar se mbrojtja u referohet dëshmimeve të dëshmitarit M.R. dhe të dhënave nga porositë SMS, ky trup gjykues pastaj u referohet gjetjeve të veta nën pjesën II. B. 1.<sup>37</sup> Nga një pikëpamje më e përgjithshme, ashtu siç është theksuar me të drejtë nga ana e prokurorit të shtetit, trupi gjykues ka të drejtë “të mbledhë prova të cilat i konsideron të domosdoshme për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të lëndës” përveç provave të propozuara nga palët dhe nga pala e dëmtuar sipas nenit 360, par. 5 të KPPK-së. Kjo prerogativë e gjyqtarit është në përputhje të plotë me nenet 386 dhe 387 të Kodit. Në fakt, disa nga dispozitat i mundësojnë gjykatës që të mbledhë prova nëse ka nevojë, për t’i mundësuar trupit gjykues “vlerësimin në mënyrë të ndërgjegjshme të secilës provë ndaras si dhe në raport me provat e tjera” dhe “që të mbështesin aktgjykimin e tyre vetëm në fakte dhe prova të shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor”, pra me fjalë të tjera që trupi gjykues të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbardhjen e së vërtetës. Gjithashtu duhet të përmendet se mbrojtja ka pasur shumë mundësi deri më tani për t’i kundërshtuar këto prova gjatë shqyrtimit gjyqësor.

43. Lidhur me pohimin mbi shkeljen e parimit *in dubio pro reo* dhe lidhur me vërtetësinë e vërtetimit të fakteve sipas neneve 3 dhe 7 të KPPK-së, kolegji i Gjykatës Supreme pajtohet se një person nuk mund të dënohet duke u bazuar në dyshim dhe se organet gjyqësore kanë për detyrë të shqyrtojnë me kujdes faktet dhe siç përcaktohet me nenin 7, par. 2 të KPPK-së “me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij [...]”. Në vendet demokratike, personi konsiderohet i pafajshëm deri në shqiptimin e dënimit, i cili ndodh kur të vërtetohet fajësia përtej çdo dyshimi. Duke bërë vërtetimin e fakteve gjykata do ta shqyrtojë lëndën si tërësi si dhe të gjitha rrethanat përkatëse. Provat e prezantuara gjatë procedurës penale duhet të jenë të forta dhe bindëse, siç janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë.

44. Në bazë të nenit 372 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues i merr në pyetje dëshmitarët vetëm kur palët nuk kanë pyetje të tjera. Por kjo nuk do të thotë në mënyrë të domosdoshme se kryetari i trupit gjykues duhet të heshtë derisa të mbarojë marrja në pyetje nga palët. Prerogativat e kryetarit të trupit gjykues për të intervenuar gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit dalin nga detyra e tij për udhëzimin e dëshmitarëve, për t’i paralajmëruar në rast të lindjes së dyshimit se nuk janë duke e thënë të vërtetën, dhe kryesisht nga roli i tij në drejtimin e procedurës penale siç përcaktohet me nenin 333, par. 1 të KPPK-së. Sa shpesh dhe në çfarë mase bëhen këto ndërhyrje nga kryetari i trupit gjykues – varet nga rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit, nga sjellja e tij dhe e palëve si dhe nga rrethanat e procedurës. Kryetari i trupit gjykues ka hapësirë për të manovruar gjatë drejtimit të shqyrtimit gjyqësor përderisa nuk ndodh ndonjë shkelje serioze e të drejtave të mbrojtjes.

**Sipas detyrës zyrtare: shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, par. 1, nënpar. 10 dhe 12 të KPPK-së dhe shkelja e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së**

---

<sup>37</sup> Arsyetimi i Gjykatës Supreme të Kosovës nën pretendimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së, paragrafi 13 e tutje



45. Sa u përket pohimeve sipas nenit 386, par. 1 të KPPK-së lidhur me nenin 403, par. 1, nënpar. 10 dhe 12 të KPPK-së, mbrojtja pretendon se Gjykata e Qarkut në dispozitiv nuk ka përmendur dispozitën kyçe me të cilën penalizohet sjellja e të pandehurve dhe se, edhe pse gjykata e shkallës së parë ka dënuar të pandehurit S.A., A.H., F.P., X.H. dhe B.A. për njëren pikë të kontrabandimit me migrantë, atyre u është shqiptuar nga një dënim ‘për secilin migrant të kontrabanduar’. Për më shumë, mbrojtja e S.A. deklaroi se vepra kontrabandim me migrantë sipas nenit 138, par. 6 duhet të lexohet në kuptim të nenit 26 mbi bashkimin kriminal prandaj edhe duhet të ndëshkohet sipas nenit 65, par. 2 të KPK-së.

46. Gjykata Supreme e Kosovës i konstaton si të bazuara pretendimet e mbrojtjes se dispozitivi nuk përmban dispozitën kyçe e cila e përmend vetë veprën penale të kontrabandimit me migrantë të kryer nga disa të pandehur sipas nenit 138 të KPK-së. Në bazë të dispozitivit, S.A., A.H., F.P., X.H. dhe B.A. janë shpallur fajtorë për kontrabandim me migrantë sipas nenit 138, par. 6 të KPK-së në bashkëkryerje. Kjo dispozitë përcakton që “Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet nga kryerësi si anëtar i grupit ose në një mënyrë e cila rrezikon ose ka gjasë të rrezikojë jetën a sigurinë e migrantëve përkatës ose që përfshin trajtimin çnjerëzor a degradues, duke përfshirë eksploatimin e migrantëve të tillë, ai dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.” Kjo dispozitë përcakton rrethanën rënduese.<sup>38</sup> Megjithatë, e njëjta nuk e përmend veprën inkriminuese e cila përcaktohet me paragrafët 1, 2 apo 3. Dispozitivi prandaj mund të bëhet i pakuptueshëm pasi që është lënë jashtë dispozita e cila i penalizon këto vepra. Megjithëkëtë, një lënie e tillë jashtë nuk e kalon pragun sa të hyjë në kategorinë e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, par. 1, nënpar. 12 të KPPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 315, par. 1, nënpar. 1 të KPPK-së, në vend të kësaj ndryshon dispozitivin duke ia shtuar referimin i cili i bëhet paragrafit 1 të nenit 138 të KPPK-së.

47. Për më tepër, Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me mbrojtjen në atë masë që në shkresa të lëndës nuk ekzistojnë elemente të cilat vërtetojnë se të pandehurit F.P., X.H. dhe B.A. kanë kryer veprat penale në bashkëkryerje sipas nenit 23 të KPK-së. Vetë fakti se i pandehuri X.H. ka vendosur kontaktin e familjes M. me të pandehurin F.P. nuk mjafton për të vërtetuar se vepra penale është kryer “bashkërisht” nga dy individët ose këta të fundit kanë kontribuar në mënyrë përmbajtësore në kryerjen e veprës. Të njëjtat gjetje vlejné edhe për B.A. Kolegji i Gjykatës Supreme, për këtë arsye, ndryshon dispozitivin e aktgjykimit të kontestuar për ta përmirësuar vlerësimin e gabueshëm të gjykatës së shkallës së parë.

48. Kolegji i Gjykatës Supreme, për më tepër, konstaton se të pandehurit A.H., S.A., I.K. dhe Smail Selmani janë dënuar gabimisht për të dyja veprat penale të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274, par. 4 dhe të kontrabandimit me migrantë sipas nenit 138, par. 6 të KPK-së. Vepra e krimit të organizuar kërkon që të plotësohet kryerja e veprës “së

---

<sup>38</sup> Shih inter alia Protokollin kundër kontrabandimit me migrantë përmes rrugëve tokësore, detare dhe ajrore, si plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërshtetëror, të miratuar më 15 nëntor 2000, neni 6.3: “3. Secila palë shtetërore duhet të miratojë këto masa legjislative dhe të tjera pasi që këto masa mund të jenë të domosdoshme për t’i konstatuar si rrethana rënduese për veprat e konstatuara në përputhje me paragrafët 1 ( a ), ( b ) ( i ) dhe ( c ) të këtij neni, përkatësisht rrethanat: (a) të cilat rrezikojnë apo kanë gjasë të rrezikojnë jetën apo sigurinë e migrantëve në fjalë; apo (b) të cilat përmbajnë në vete trajtim çnjerëzor apo degradues, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e këtyre migrantëve.” Shih po ashtu udhëzimet legjislative për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërshtetëror si dhe protokolleve të saj, të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për narkotikë dhe krim, divizionit për çështje të marrëveshjeve, Nju Jork 2004, pjesa e tretë, faqet 346 – 374.

pavërejtur”, përveç veprës së krimit të organizuar sipas nenit 274 të KPK-së. Formulimi i përdorur nëpër tërë nenin 274 të KPK-së në mënyrë të qartë përcakton që kryerja e veprës themelore është element përbërës i kësaj vepre. Përndryshe, një individ mund të shpallet fajtor për të njëjtën vepre, duke u bërë pjesë e të dyja veprave penale, pra të krimit të organizuar dhe të veprës së pavërejtur. Kjo gjendje mund të përbëjë shkelje të ndalimit për shqiptimin e dënimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale. Në lëndën në fjalë, vepra e krimit të organizuar në një masë të caktuar përfshin edhe veprën penale të kontrabandimit me migrantë. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se të pandehurit A.H., S.A., I.K. dhe S.S. janë fajtorë për kryerjen e veprës penale Krim i organizuar në kundërshtim të nenit 274 paragrafit 4 ‘në lidhje me veprën penale Kontrabandimi me migrantë në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së’.

49. Ky gjithashtu është edhe qëndrimi i Gjykatës Supreme se vetëm faktet e prezantuara në aktakuzë përcaktojnë fushëveprimin e akuzës, jo vlerësimi ligjor i prokurorisë apo forma e përgjegjësisë penale. Kjo në mënyrë të qartë është e rregulluar me nenin 386 paragrafin 2 të KPPK-së i cili thotë se gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit lidhur me cilësimin juridik të veprës. Duke pasur parasysh kompetencat në diskrecion të Gjykatës Supreme si gjykatë e shkallës së dytë, cilësimi juridik i veprës penale dhe forma e përgjegjësisë penale (nga bashkëkryerja në kryerje), janë ndryshuar në pajtueshmëri.

50. Rrjedhimisht, kolegji i Gjykatës Supreme nuk ka nevojë t’i përgjigjet argumentit të avokatit mbrojtës Florin Vertopi në lidhje me zbatimin e nenit 26 të KPK-së mbi bashkimin kriminal.

51. Si rrjedhojë e asaj që u tha më lartë, kolegji i poshtë nënshkruar konsideron se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka dënuar të pandehurit me dy dënime, njërin për Krim të organizuar dhe tjetrin për Kontrabandim me migrantë.

52. Sipas mendimit të kolegjit të Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka shqiptuar një dënim “për një migrantë të kontrabanduar” nën veprën penale Kontrabandimi me migrantë. S.A., A.H., F.P. dhe B.A. janë dënuar me “2 vite burgim për secilin migrantë të kontrabanduara në lidhje me veprën penale Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje, në kundërshtim të nenit 138, paragrafit 6 dhe nenit 23 të KPK-së ...” Sa i përket X.H., ai është dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim për secilin migrantë të kontrabanduara. Gjykata e shkallës së parë nuk ka ofruar asnjë arsytim sa i përket shqiptimit të dënimeve të shumëfishta përveç “ se kontrabandimi i secilit migrantë përbën kryerje të një vepre penale në kundërshtim të nenit 138 paragrafit 6 të KPK-së, prandaj i pandehuri i lartpërmendur ka kryer pesë vepra penale në kundërshtim të nenit 138, 6 të KPK”.<sup>39</sup> Gjykata Supreme e Kosovës vëren se të pandehurit janë shpallur fajtorë vetëm për një vepër penale Kontrabandimi me migrantë, siç është përcaktuar qartë në dispozitiv (dhe gjithashtu edhe në aktakuzë), por janë dënuar për pesë vepra penale të ndara. Neni 138 i KPK-së nuk parasheh rregulla të tilla të veçanta mbi llogaritjen e dënimit i cili duhet të shqiptohet për veprën penale kontrabandimi me migrantë. Ky lloj i llogaritjes nuk është përcaktuar as në Kapitullin III të Kodit mbi dënimet. Shqiptimi i disa dënimeve me burgim pa bazë ligjore mund të shpie në shkelje të rënda të rregullave të përgjithshme mbi llogaritjen e dënimeve dhe dobëson parimin e parashikueshmërisë së ligjit penal.

---

<sup>39</sup> Shih Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, faqet 5 deri në 7 të dispozitivit mbi dënimin; gjithashtu shih Pjesën V. Përcaktimi i dënimeve, faqet 65-67 dhe në vijim

53. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës *ex officio* ndryshon dispozitivin për të shqiptuar vetëm një dënim për një të pandehur për veprën penale Kontrabandim me migrantë sipas nenit 138 paragrafit 6 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së.

## **II. C. 2. Pretendimet për shkeljen e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së**

54. Mbrojtja pohon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal sipas neneve 11 paragrafit 1, 14, 15 dhe 71 të KPK-së si pasojë e shkeljes substanciale të ligjit procedural dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Për më tepër, mbrojtja pohon se kolegji i Gjykatës së Qarkut ka shkelur nocionin e ‘bashkimit të veprave penale’ të cilat mund të parashihen vetëm kur një vepër penale konsiderohet të jetë kryer edhe pse janë kryer akte të shumëfishta. Kjo mund të bëhet vetëm në rast të veprës penale të ndërlikuar, veprës penale në vazhdimësi apo veprës kolektive.

55. Mbrojtja, respektivisht avokati mbrojtës i të pandehurit F.P. dhe avokati mbrojtës i të pandehurit X.H., pretendojnë në shkelje të ligjit penal sipas nenit 138 paragrafit 1 të KPK-së, duke pasur parasysh elementet e veprës penale Kontrabandimi me migrantë, p.sh. përfitimi material i drejtpërdrejt apo jo i drejtpërdrejt dhe dashja e drejtpërdrejt, nuk janë përmbushur në lëndën në fjalë. Mbrojtja gjithashtu pretendon se neni 274 i KPK-së mbi Krimin e organizuar kërkon kryerjen e veprës penale fillestare, si kusht i veprës penale Krim i organizuar. Në këtë rast, trupi gjykues nuk ka vërtetuar elementin përbërës të veprës penale.

56. Prokurori i shtetit pohon se nuk është bërë asnjë shkelje e ligjit penal nga trupi gjykues sipas nenit 404 të KPPK-së, sepse provat e administruara mjaftojnë për të vërtetuar kryerjen e veprave penale dhe përgjegjësinë e të akuzuarve.

57. Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon si të pabazuar, madje edhe si panevojshëm, argumentin në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 11 paragrafit 1, neneve 14 dhe 15 të KPK-së. Kolegji i poshtë nënshkruar pyet vetën nëse mbrojtja pret që dispozitivi të përfshijë të gjitha nenet e referuara në Kod në lidhje me përgjegjësinë penale të akuzuarit, formën e saj, ekzistimin e lidhjes shkakore. Kjo do ta bënte dispozitivin shumë të gjatë dhe të ndërlikuar, dhe si pasojë e kësaj të pakuptueshëm. Elementet e vetme të detyrueshme të dispozitivit janë artikuluar në nenin 391 në lidhje me nenin 396 paragrafin 3 të KPPK-së. Në lidhje me arsyet tjera, ky kolegji i referohet gjetjeve të saj nën pjesën II.B.1 mbi pretendimet e shkeljeve sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafëve 10 dhe 12 dhe nenit 404 të KPPK-së.

58. Nga dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimi është e qartë se gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim se i pandehuri X.H. ka kontribuar në kontrabandim, në atë mënyrë që ka rrezikuar jetën e njerëzve. Fakti se i pandehuri ka pranuar vetëm marrjen e parave nga familja M. nuk do të thotë se aktiviteti i tij nuk ka pasur për qëllim përfitimin e dobisë pasurore. Përveç kësaj, ai ka përgatitur transportimin e migrantëve duke kontaktuar të pandehurin F.P.. Përfundimisht, Gjykata Supreme e Kosovës nuk gjen asnjë kundërthënie në mes të lirit të pandehurit nga akuza për Krim të organizuar dhe dënimin të tij për veprën penale Kontrabandimi me migrantë.

## **II. C. 3. Pretendimi për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së**

59. Mbrojtja kundërshton gjetjet e shkallës së parë lidhur me gjendjen faktike, respektivisht lidhur me periudhën inkriminuese, aktet konkrete dhe individuale të kryera nga

secili i akuzuar, mjetet e kryerjes së veprave penale si dhe roli i secilit të dyshuar në grupin e organizuar kriminal. Avokati Bajram Tmava përmend se i pandehuri A.H. ka mohuar marrjen e kompensimit për transportimin e migrantëve dhe njohjen e të bashkëpandehurve. Përveç kësaj, ai kundërshton dëshmitë e disa dëshmitarëve (B.R., E.R., M.J., A.A., B.J., B.M., B.H. and D.V.) dhe deklaratat e të bashkëpandehurve. Avokati mbrojtës Florin Vertopi në emër të pandehurit S.A., duke cituar artikujt e studiuesve dhe komentareve sipas ligjit të vjetër, jep një interpretim të elementeve të veprës penale Krim i organizuar; nocioneve të lidhjes shkakore sipas nenit 14 dhe të dashjes sipas nenit 15 të KPK-së për të pohuar se asnjë provë nuk vërteton lidhjen shkakore në mes S.A. dhe ngjarjeve.<sup>40</sup>

60. Avokati mbrojtës i F.P. konteston gjetjet e gjykatës së shkallës së parë duke kundërshtuar saktësinë e deklaratave të dëshmitarëve H.C., Z.M-K. dhe R.Z. dhe besueshmërinë e të pandehurit X.H.. Avokati Hilmi Zhitija i të pandehurit X.H. pohon se trupi gjykues gabimisht ka përmendur se ai ka qenë pjesëtar i grupit kriminal dhe se ka vepruar në bashkëkryerje me individë të tjerë. Ai gjithashtu thekson se dashja e X.H. për të përfituar dobi pasurore nuk është vërtetuar për ta dënuar atë për veprën penale Kontrabandim me migrantë.

61. Avokatët mbrojtës Qerim Zocaj dhe Ndue Thaqi pohojnë se bisedat telefonike dhe ekstraktet e mesazheve nuk përmbajnë asnjë element inkriminues kundër të pandehurit. Nëse S.S. dhe I.K. do të shpallehin fajtorë për Krim të organizuar, ata do të duhej të ishin fajtorë për veprën penale fillestare Kontrabandimi me migrantë nga e cila rrjedh vepra penale Krim i organizuar. Mbrojtja pretendon se gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se të dy të pandehurit kanë qenë kryesorët për kontaktet me migrantët. Avokati mbrojtës i B.A. pohon se kolegji i Gjykatës së Qarkut nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur deklaratat e dëshmitarëve S.A.2 dhe I.K. dhe nuk ka marrë parasysh mundësinë për ta ftuar Lavdim Thaqin në gjykatë. Për më tepër, ai pohon se pasi që B.A. ka qenë në Zvicër në kohën e veprave penale, ai nuk ka mundur t'i kryejë aktet inkriminuese.

62. Prokurorja e shtetit nuk pajtohet me pretendimet për shkelje substanciale të ligjit të procedurës sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 12 të KPPK-së, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së. Sipas mendimit të saj, saktësia e gjetjeve faktike në shkallë të parë është vërtetuar nga procesverbalit i gjykimit, mesazhet e dërguara te i pandehuri dhe vendndodhja e tyre.

63. Shumica e pretendimeve të mbrojtjes sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike p.sh. përgjegjësia e të pandehurve si bashkëkryerës, dhe për secilën veprë penale, ekzistimin e lidhjes shkakore dhe dashjes, tanimë janë adresuar nën pjesën II.B.3. të këtij aktgjykimi.

64. Përkundër mendimit të mbrojtjes, kolegji i Gjykatës së Qarkut ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike relevante për të gjithë të pandehurit. Për këtë qëllim, Gjykata Supreme e Kosovës i referohet arsyetimit të aktgjykimit në vërtetimin e saj të fakteve<sup>41</sup> dhe të

---

<sup>40</sup> Avokati mbrojtës Florin Vertopi pretendon se nuk ekziston asnjë provë kundër S.A. për të vërtetuar ekzistimin e tetë kushteve të veprës penale Krim i organizuar: bashkimi afatgjatë, përfitimi i madh, struktura organizative, aksioni i planifikuar, fleksibiliteti për të kryer akte të kundërligjshme, teknologjia dhe metodat e kryerjes së veprës, ndërkombëtarizimi dhe lëvizshmëria e detyrueshme, dhe lidhjet me krimin e organizuar me shtetin dhe lidhshimin politik.

<sup>41</sup> Shih Gjykata e Qarkut në Prishtinë, lënda P nr. 244/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, 17 qershor 2011, Pjesa 2. Rekonstruktimi faktik i ngjarjeve dhe vlerësimi i provave të prezantuara, faqet 10 dhe në vijim

përgjegjësisë për secilin të pandehur.<sup>42</sup> Nuk ekziston asnjë indikacion se Gjykata e Qarkut nuk ka eksploruar në mënyrë të sinqertë rrethanat e lëndës dhe ka zhvilluar procedurën në mënyrë të drejtë dhe objektive. Gjykata Supreme pajtohet se disa formulime të përdorura nga trupi gjykues mund të duken pak si të paqarta.<sup>43</sup> Sidoqoftë, gjetjet e trupit gjykues nuk janë bazuar në supozime. Gjykata e shkallës së parë në të vërtetë ka arsyetuar mirë vlerësimin e saj të provave, përfshirë besueshmërinë e dëshmitarëve S.A.2 dhe I.K. dhe peshën e deklaratave të tyre, për të marrë vendimin mbi fajësinë.<sup>44</sup> Gjykata e Qarkut gjithashtu ka analizuar gjatë deklaratën e të pandehurit B.A. dhe jep një arsyetim të detajuar mbi vlerësimin e saj.<sup>45</sup>

## **II. C. 4. Pretendimet në lidhje me vendimin mbi sanksionet penale sipas nenit 406 të KPPK-së**

65. Avokatët mbrojtës pretendojnë se vendimi mbi dënimin nuk ka baza ligjore pasi që elementet e veprave penale Krim i organizuar dhe Kontrabandimi me migrantë nuk ekzistojnë në këtë lëndë. Mbrojtja konteston dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve si tepër të ashpër. Më tutje, gjykata e shkallës së parë nuk e ka individualizuar atë. Avokati Florin Vertopi në emër të pandehurit S.A. paraqet rrethanat lehtësuese në vijim: sjellja e të pandehurit në të kaluarën; sjellja e mirë e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor; pranimi i fajësisë dhe pendimi; dhe gjendja e tij financiare e dobët. Prandaj, ai kërkon nga kolegji i Gjykatës Supreme që të zbatojë nenin 66 të KPK-së mbi rrethanat posaçërisht lehtësuese. Avokati mbrojtës Hilmi Zhitija sugjeron se duke pasur parasysh gjendjen e tij financiare të dobët, X.H. duhet patjetër të lirohet nga pagesa e shpenzimeve.

66. Sipas mendimit të Prokurores së shtetit, dënimet e shqiptuara reflektojnë rëndësinë e veprave penale, rrezikshmërinë e tyre shoqërore dhe mënyrën e kryerjes. Ato përputhen me qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 34 të KPK-së.

67. Siç është cekur më lart, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se në lidhje me veprën penale Kontrabandimi me migrantë, kolegji i Gjykatës së Qarkut gabimisht ka shqiptuar disa dënime në vend të një dënimi të vetëm.

68. Përndryshe, është vërejtur se trupi gjykues ka marrë parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese për secilin të pandehur, siç është përcaktuar me nenet 34, 42, 43, 54 dhe nenin 64 dhe nenet në vijim të KPPK-së. Trupi gjykues ka marrë parasysh faktorët rëndues: rëndësinë ekstreme të veprave penale të kryera qëllimisht për përfitime të dobisë pasurore; mohimin e kryerjes nga të akuzuarit S.A., A.H., I.K., S.S. dhe F.P.; dhe sjelljen në të kaluarën të pandehurve (dënimi i mëparshëm i të pandehurit F.P.). Kolegji i Gjykatës së Qarkut, përveç kësaj, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese: faktin se B.A. është dorëzuar vullnetarisht në polici, se ai ka hequr dorë nga e drejta në seancën për konfirmim, dhe se i ka siguruar gjykatës informata lidhur me rolin dhe

<sup>42</sup> Ibid, Pjesa 2 dhe Pjesa 3. Cilësimi juridik, faqet 58 dhe në vijim

<sup>43</sup> Ibid, faqe 61: “Është rasti të përmendet se i njëjti konstatim do të ishte gjithashtu i vlefshëm për të pandehurit e tjerë (S.S., I.K., B.A.), në (sinqerisht pabesueshëm) rast se dikush do të mund ta konsideronte të paprovuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ata kanë pasur përfitime materiale. Në fakt, rrethanat e pamohueshme se ata kanë pasur njohuri për bashkëpunimin në aktivitete kriminale, e cila në mënyrë të sigurtë ka bërë që personat e tjerë të kenë përfitime materiale, vërteton fuqishëm fajësinë e tyre mbi bazën e parimit të sqaruar më lart.”

<sup>44</sup> Ibid *inter alia* Pjesa 2.2.3. Kontrabandimi i I.A., faqet 18 dhe në vijim; 2.2.4. Kontrabandimi i L.K., A.K. dhe A.K.2, faqet 24 dhe në vijim

<sup>45</sup> Ibid, faqet 41 dhe në vijim

strukturën e organizatës kriminale; se të pandehurit S.A., B.A., A.H., I.K., S.S. dhe X.H. nuk kanë pasur dënime të mëparshme.

69. Në lidhje me S.A. i cili në ankesën e tij i ‘ka pranuar’ veprimet e tij, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se dënimi i shqiptuar në shkallën e parë arsyetohet duke pasur parasysh rrethanat e lëndës.

70. Gjykata Supreme e Kosovës gjithashtu gjen se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat mbi rrethanat posaçërisht lehtësuese të pandehurit X.H., “sjellja e tij e sinqertë gjatë gjithë gjykimit dhe shkalla e ulët e përgjegjësisë së tij penale”.

71. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës i refuzon si jomeritore pretendimet e mbrojtjes në lidhje me këtë.

72. Propozimet e avokatëve mbrojtës për ndërprerjen e paraburgimit ndaj të pandehurve I.K. dhe F.P., refuzohen si të pabazuara.

73. Prandaj, është vendosur si në dispozitiv.

**Kryetar i kolegjit**

\_\_\_\_\_  
Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtare e kolegjit**

\_\_\_\_\_  
Marije Ademi, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Anëtar i kolegjit**

\_\_\_\_\_  
Martti Harsia, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtare e kolegjit**

\_\_\_\_\_  
Valdete Daka, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Anëtar i kolegjit**

\_\_\_\_\_  
Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**Procesmbajtëse**

\_\_\_\_\_  
Chiara Rojek, Zyrtare ligjore

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Ap-Kz nr. 61/2012**  
**2 tetor 2012**  
**Prishtinë**